



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 22268142; 22268141

Nr. 85/5 Prot.

Tiranë, më 06.06.2017

V E N D I M

Nr.127, datë 06/06/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 109, datë 02.11.2016 dhe ligjshmërisë e veprimeve administrative të kryera nga Agjencia Kombëtare e Duhan – Cigareve, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 01.08.2016 e në vazhdim"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 109, datë 02.11.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Agjencia Kombëtare e Duhan - Cigareve, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave", në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Duhan – Cigareve,

VËREJ SE:

Bazuar në Vendimin Nr. 138, datë 30.12.2015 "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", ka filluar mbikëqyrja e përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Agjencia Kombëtare e Duhan – Cigareve. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 109, datë 02.11.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Agjencia Kombëtare e Duhan - Cigareve, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Agjencia Kombëtare e Duhan - Cigareve, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.

2. *Njësia e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur në bashkëpunim me njësinë e burimeve njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Departamentin e Administratës Publike, gjatë shpalljes së procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, duhet të kujdesen për të saktësuar, të drejtën për të konkurruar, duke përfshirë jo vetëm nëpunësit e të njëjtës kategori, por edhe pozicionet analoge, me emërtesa atipike, të cilat i përkasin kryesisht institucioneve që kanë hyrë rishtas në shërbimin civil dhe ndërkohë funksionojnë me legjislacionin, i cili ka qenë në fuqi, para hyrjes në shërbimin civil.*

Për të siguruar zbatimin e ligjit në këtë drejtim, duhet të përshtasin legjislacionin specifik me ligjin për shërbimin civil, me qëllim që të eliminohet mospërputhja që krijohet në emërtesat e pozicioneve të punës dhe nivelin e pagës, me klasifikimin e pozicioneve në legjislacionin për nëpunësin civil.

Të pasqyrohen këto raste edhe në përshkrimin e punës për pozicionet konkrete, ashtu si është rasti i Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Duhan – Cigareve në këtë institucion.

3. *Institucioni i mbikëqyrur, duhet të organizojë punën për nënshkrimin e përshkrimit të punës nga nëpunësit civilë të rekrutuar rishtas, duke krijuar mundësinë e njohjes dhe dakordësinë e tyre me dokumentin.*

Gjithashtu, mbështetur në dispozitat ligjore, i gjithë procesi i hartimit, miratimit dhe nënshkrimit të përshkrimeve të punës nga strukturat përgjegjëse, pjesëmarrëse në këtë proces, duhet të përfundojë me dokumentimin e tyre, duke i depozituar në Departamentin e Administratës Publike dhe më pas një kopje, duhet të vendoset në dosjen individuale të personelit.

4. *Strukturat e institucionit, përgjegjëse për vlerësimin, të përfundojnë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për 6 mujorin e parë të vitit 2016, sipas procedurave të hollësishme të parashikuara në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të ndryshuar dhe lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe sipas rekomandimeve të materializuara në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes.*

Në vazhdim, të përmbyllë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për drejtorin e institucionit, duke i përcjellë zyrtarisht, titullarit të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (si institucion nga i cili varen), formularin e vlerësimit. Më tej të vazhdohet procedura e hollësishme për vlerësimin e tij, sipas përcaktimeve të legjislacionit për nëpunësin civil.

5. *Të plotësohet dosja e personelit me të gjitha dokumentet e evidentuara në mungesë, në tabelat aneks, bashkëlidhur këtij raporti, sipas orientimeve në raportin e mbikëqyrjes.*
6. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijëni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar Nr. 109, datë 02.11.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Duhan - Cigareve, prej datës 01.08.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, me Vendimin Nr. 14, datë 08.02.2017, *“Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 109, datë 02.11.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Agjencia Kombëtare të Duhan - Cigareve, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 01.08.2016 e në vazhdim”*, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 109 datë 02.11.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Agjencia Kombëtare e Duhan - Cigareve, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”*.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Duhan - Cigareve, dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën Nr. 85/2 prot., datë 08.02.2017 *“Njoftim për fillimin e verifikimit”*.

Bazuar në procesverbalin e mbajtur me datë 10.02.2017 nga grupi i punës i Komisionerit dhe nënshkruar edhe nga personat e kontaktit të institucionit të Agjencisë Kombëtare të Duhan - Cigareve, dhe pas shqyrtimit të materialeve shkresore të administruara në përfundim të procesit të verifikimit, rezultoi sa më poshtë vijon:

- Në lidhje me detyrën që i është lënë njësisë përgjegjëse në pikën 2 të dispozitivit të vendimit që në procedurat e ardhshme për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, të tregojë kujdes që në aktin e shpalljes të saktësojë të drejtën për të konkurruar, duke përfshirë jo vetëm nëpunësit e të njëjtës kategori, por edhe pozicionet analoge, me emërtesa atipike, të cilat i përkasin kryesisht institucioneve që kanë hyrë rishtas në shërbimin civil dhe ndërkohë funksionojnë me legjislacionin, i cili ka qenë në fuqi, para hyrjes në shërbimin civil, rezultoi se deri në momentin e verifikimit nuk ishte kryer asnjë procedurë e tillë. Ndërkohë, rezultoi gjithashtu, se ishte formuar grupi i punës për hartimin e ndryshimeve të ligjit të posaçëm me qëllim përshtatjen e tij me ligjin për shërbimin civil, për të eliminuar mospërputhjen e krijuar në emërtesat e pozicioneve të punës dhe nivelin e pagës, me klasifikimin e pozicioneve në legjislacionin për nëpunësin civil.
- Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, në zbatim të pikës 3 të vendimit, ka organizuar punën dhe ka administruar në dosjet personale përshkrimet e punës të nënshkruara nga nëpunësit civilë të rekrutuar rishtazi. Me shkresën nr. 178 prot., datë 21.11.2016, *“Dërgohen përshkrimet e punës”*, këto të fundit janë depozituar edhe pranë Departamentit të Administratës Publike.
- Në zbatim të pikës 4 të vendimit paralajmëruar të Komisionerit, struktura përgjegjëse për procesin e vlerësimit të rezultateve në punë ka përfunduar procesin për përmbylljen e vlerësimeve për 6 mujorin e parë të 2016, sipas procedurave të hollësishme të përcaktuara në Vendimin Nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, të ndryshuar dhe lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Gjithashtu u administrua dhe formulari i vlerësimit të punës, i titullarit të institucionit, i cili është vlerësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, sipas përcaktimeve të legjislacionit për nëpunësin civil.

- Në përputhje me orientimet në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes dhe në zbatim të pikës 5 të vendimit të Komisionerit, janë plotësuar dosjet e personelit me dokumentacionin e evidentuar në mungesë, në përputhje me Vendimin Nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 109 datë 02.11.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Agjencia Kombëtare e Duhan - Cigareve, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”*, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe 34 të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 109, datë 02.11.2016 në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Duhan - Cigareve.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Agjencisë Kombëtare të Duhan - Cigareve, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 109, datë 02.11.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Agjencia Kombëtare e Duhan - Cigareve, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”*.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Agjencisë Kombëtare të Duhan – Cigareve, Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Departamenti i Administratës Publike dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA